

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 28/04/2026
PRIMLJENO:
02/123



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Nr. 02/
Datë:18.03.2026

Procesverbal
i mbledhjes së -I-(parë) të jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa

RENDI DITËS

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së parë të rregullt të mbajtur me datë:26.02.2026.
- 2.Shqyrtim dhe miratim i kërkesës nr.01/451 datë:03.03.2026 e parashtruar nga Kryetari i Komunës,për miratim të listës së pronave të paluajtshme të komunës së Malishevës,për dhënie në shfytëzim gjatë vitit 2026.
- 3.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për ngritje të tarifës së shërbimit të mbeturinave nga "EKO-Regjioni"SHA.A.Prizren.
- 4.Të ndryshme.

Takimi u mbajtë me datën:18.03.2026 filloi ne ora :13:30.

Në takim morën pjesë Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj,antarët e këtij Komisioni,zyrtar ligjor z.Muharrem Morina,përfaqësues nga zyra e informimit z.Izet Shala.

Mungoi:Halil Morina anëtarë nga radhët e partisë Nisma Socialdemokrate njëherit edhe anëtarë i këtij komisioni.

Kryesues i Komisionit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Përshëndetje për të gjithë,pasi që kemi korum të mjaftueshëm atëherë fillojmë me mbledhjen e parë të jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa,rendin e ditës e keni pranuar me kohë përmes emailit tuaj zyrtar atëherë e hedhi në votim rendin e ditës.Kush është për?

Rendi i ditës u miratua me këto vota.

Për 5 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 1 vota.

Pika 1

Pika e parë e rendi të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së parë të rregullt të mbajtur me datë:26.02.2026.

Miratohet rendi i ditës unanimshtë nga të gjithë të pranishmit.

Për 6 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 0 vota.

Pika 2

Pika e dytë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/451 datë:03.03.2026 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për miratim të listës së pronave të paluajtshme të komunës së Malishevës, për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026.

Më lejoni edhe një herë që të ju rikujtoj që ju keni qenë në seancën e parë të rregulltë të mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, me të cilën këtë pikë të rendit të ditës e kemi tërhequr dhe e kemi bartur për ta trajtuar në Komitet për Politikë dhe Financa. Materialin punës e keni pranuar me kohë.

E hapi debatin për diskutim për këtë pikë të rendit të ditës. Nëse keni sygjerim për të hequr ndonjë pronë apo për të shtuar. Fjalën e ka kërkuar z. Veton Zogaj. Urdhëro.

Veton Zogaj (anëtarë i Komitetit të KPF-së): Faleminderit Kryesus. Përshëndetje koleg Asambleistë dhe ju të pranishëm. Në seancën e mbledhjes së Kuvendit Komunal kam propozuar që të largohet kjo pikë e rendit të ditës sepse kërkohet që të kalonë së pari në Komitet për Politikë dhe Financa. Ajo qfarë jam duke e vërejtur në vazhdimësi është që ne jemi duke i përdorur disa shabllone në të kaluarën mirëpo prapë nuk jemi duke i përmirësuar.

Unë i ruaj të gjitha material e legjislativës së Asamblesë që i dërgoni, kjo listë e pronave është e njejtë nga tri vitet njejtë që janë përcjellur. Në procesë verbal shkrunë që vazhdimisht e kam kërkuar e që Komuna domosdoshmërishtë e ka për obligim që ta miratojë një listë të pronave për të dhënë në shfrytëzim brenda vitit kalendarik për muajin janar-dhjetor 2026 në këtë rast . i bie prej muajit mars, aty janë përfshirë të gjitha listat e pronës në mënyrë krejtë bllanko.

Unë kam kërkuar nga MAPL-ja një interpretim ligjor dhe ata më kanë thënë nuk është e obliguar Komuna me i futur të gjitha listat e pronave publike, ajo qfarë e bënë një target një zonë të pronave të cilat dëshironë me i dhënë në shfrytëzim aty e evidentonë një listë të cilat i shtonë i përditësonë. Ne jemi duke i futur të gjitha pronat egzistenciale të Komunës në pronë publike dhe pastaj ne si Asambleistë nuk jemi duke e ditur se për qfarë po bëhetë fjalë, nëse do të ishte njëzetë apo tri dhjetë.

Nëse do të ishte njëzetë apo tri dhjetë unë do të kisha kërkuar nga Drejtori i Gjeodezisë me na dhënë në mënyrë specifike dhe vizuale se ku ndodhën këto prona. Unë përveti e kam pasur një komunikim formal së bashku me Drejtorin dhe disa herë i kam thënë jo të gjithë e kanë qasjen njejtë sikur në Asambleistët në gjeo portal dhe disa dokumentë të tjera zyrtare. Qytetarëve duhet me ja'u thjeshtësuar punën në mënyrë që ata me ditë më lehtë. Tani e kemi bllanko në fshatin Bellanicë vetëm kompaninë jam duke i parë njëzetë apo tri dhjetë prona kjo për mua është e pa pranueshme.

Unë kam kërkuar shpeshë herë që kjo listë me u përditësuar me larguar disa prona që janë kotë sepse në fshatin Lladrocë janë pesë apo gjashtë prona private zona që nuk ju duhenë askujtë vetëm nëse dikush në të ardhmën e kërkonë për gurë thyer pse me evidentuar në listën për dhënie në shfrytëzim kurse për pronat publike realishtë të Komunës nuk e vendosim në listë me shprehë interesë dikush me ta marrë për gurë thyer apo diçka tjetër. Janë disa prona që duhet me i evidentuar në listë sepse pastaj ka operatorë ekonomikë apo biznese që shprehin interesë me i marrë në shfrytëzim.

Unë jam në parim që listën e pronave me votuar sepse jemi të obliguar,por jo në formatin e kësaj liste,kjo ka qenë edhe arsyeja që atë ditë në Kuvend kam kërkuar me larguar këtë pikë që me pasur një debate më të ngushtë këtu me kërkuar nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Katastër që me përditësuar listen me shkurtuar listën.Faleminderit.

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Veton.A ka dikush nga anëtarë e Komitetit me marrë fjalën?Fjalën e ka kërkuar z.Imran Xhyliqi.Urdhëro.

Imran Xhyliqi(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Unë dëshirojë të ndërlihem te pika e dytë atë qfarë e tha pak a shumë Vetoni.A kanë të gjitha pronat fletëposeduse të cilat ipen në shfrytëzim?Cila është arsyeja që janë duke u dhënë këto prona?Unë kam parë që shumica e pronave ishin tokë bujqësore që i themi në zhargonin popullorë djerinë të klasit të pestë.Për qfarë arsyeje janë duke u dhënë?A kanë ndonjë arsyeje specifike që janë duke u dhënë për shembull për efijencë të energjisë solare ose diqka tjetër apo nuk kanë,apo janë duke u dhënë kotë nuk jam duke e ditur pse.Diqka tjetër nuk kam.

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Faleminderit.A ka dikush nga anëtarët e Komitetit për me marrë fjalën?Unë faktikishtë kam pritur që me qenë prezentë edhe Drejtori këtu për me trajtuar më hollësishtë por mbi të gjitha,temat të cilat i ngriti Vetoni edhe Imrani janë tema të cilat botërishtë janë të ditura nuk mundemi me i ngushtuar pronat në kuptimin e listës sepse munden me pasur interesë palët për të kërkuar dhënie në shfrytëzim ose institucioni vetë Komuna e Malishevës mundet me pasur aksesë pas gjashtë muajve për ndonjë pronë të caktuar,arsyeja pse Komuna është e fokusuar më shumë në:Llozicë,Balincë ose në Lladrocë është për shkakë se aty ka më shumë prona komunale dhe janë me fleta poseduse të Komunës.

Kështu që unë nuk kam të drejtë me u lëshuar më hollësishtë në qështje teknike të cilat i kërkon por më shumë mire me aspektin politikë,unë edhe herën e kaluar e kam cekuar se komitetin më shumë e trajtojë në aspektin politikë që kanë grupet parlamentare.Mënyra si e shohë unë aspektin politikë është e njejtë si në Komitet ashtu edhe në Kuvend.

Përndryshe Veton edhe nga seanca e kaluar qështjen të cilën e ke ngritur përmes rrjeteve sociale,unë e vlersojë që nuk duhet bërë disa tema ku ka kuantitet të plotë në Kuvend mirëpo me propozimin tim dhe me miratimin e Kuvendit u tërhiqen disa pika të rendit të ditës meqenëse e gjetëm një gjuhë të përbashkët.

Në seanca unë përpiqem ta luajë rolin unifikues,mos të bëjmë politikë sepse të gjithë e kemi mundësinë me bërë politikë sepse dikush i ka trembëdhjetë vota në Asamble Komunale dhe pothuajse të gjitha qështjet i kalonë,kurse dikush i ka pesë e dikush tri nëvaret në bazë të përçindjes por të silleni konformë disa deklarimeve apriori mos të bëhet që një mundësi e vogël e unifikimit në seancë të hidhet vota,të cilën ju shpeshë herë e keni thënë që mos të trajtohet vetëm vota në Asamble Komunale por të jetë komunikimi i përgjithshëm.

Mos e dëmtoni komunikimin e përgjithshëm vetëm për një "like"(pëlqim) me të cilën mirren katërmbëdhjetë apo pesëmbëdhjetë pëlqime për atë postim,kështu që të trajtojmë në mënyrë më profesionale e sidomos nga antarët e KPF-së.

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Fjalën e ka kërkuar z.Veton Zogaj.Urdhëro.

Veton Zogaj(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Faleminderit Kryesus.Unë nuk e peshojë qëndrimin tim politikë me "like"(pëlqime) përmes rrjeteve sociale,nëse e keni lexuar kompeltë statusin tim unë e kam shkruar me mbështetjen e kompeltë Asamblesë është e vërtetë që ka qenë propozim i imi dhe është mbështetur edhe nga grupet e tjera politike kjo është e cekur në statusë publikë.

Unë nuk dëshurojë të ndalem shumë në këtë debatë por dëshirojë z.Muharremin me pytur:Nëse miratohet kjo listë në aspektin ligjorë a duhet prapë edhe vitin e ardhshëm njëjtë me votuarë?

Nëse votohenë këto prona e merrë vendimin Kuvendi Komunal dhe mbesin ato në data bazën e Komunës për me i shfrytëzuar edhe nëse nuk i shfrytëzonë brenda vitit kalendarikë?

A ka hapsirë ligjore që ne mos me votuar kotë të njëjtë listë në secilin vitë që vjenë?

Kryesus i Komiteti për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Fjalën ja kalojë z.Muharremit për interpretim ligjorë.

Muharrem Morina(zyrtar ligjorë në Kuvendin Komunal):Faleminderit Kryesus.Përsëndetje antarë të Komitetit,staffi mbështetës,Drejtorë për Ekonomi dhe Financa.

E para në kërkesën që e bëre ti për pronatë publike është e vërtetë për pronat publike që i kemi përfshirë në tërësi në listë është e vërtetë që kjo vazhdimishë është duke u përsëritur nganjëherë është shtuar apo larguar ndonjë parcellë,por nëse i keni kushtuar vëmendje asaj liste në atë listë shkruanë lista me prioritetë këto janë prona të cilat Komuna i ka me prioritetë për shkakë se ka interesë edhe prej palëve të treta me i marrë sepse ka shfaqur interesë,do të ju tregojë një rast vitin e kaluar një kompani Austriake prej Austrisë i ka dërguarë email Kryetarit të Komunës por normalishtë që pasataj Kryetari ma ka treguar mesazhin edhe mua që është i interesuarë me marrë prona publike për prodhimin e energjisë solare,do me thënë prej maps(hartës) hynë atje në Kosova Geoportal (Geoportali i Kosovës) dhe i shehë të gjitha pronat,pastaj ka edhe studime se në cilat pjesë energjia diellore është në kohë më të gjatë ata i studiojnë këto gjëra sepse diellin kanë me marrur si lëndë të parë.Lista e dytë përfshirë tërësinë e pronave.

Në listën e dytë janë pronat të cilat kanë interesë fermerët për me marrë pronën publike në shfrytëzim dhe atë parcellë në shumicën e rasteve pastaj me bërë fermë, por nganjëherë munet me pasur edhe për ndonjë interesë tjetër.

Për mos me penguarë ne atë fermerë mos me ja kufizuarë të drejtat e kemi future këtë pronë në listen më të gjerë,mirëpo nëse ka kërkesa të tilla që gjatë kohës keni me pasur kërkesa që kanë me ju drejtuarë palët ose ligji e mundësonë që edhe pala me bërë kërkesën por edhe Kryetari.Kërkesa do të vie në Komitetë dhe shkonë pastaj në Kuvend dhe mirret një vendim varësishtë si e arsyetonë Kuvendi dhe pastaj ajo parcelë shpallë kritere se cilat duhet me i plotësuarë pala për me përfiturë.

Me ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale kërkohetë që prona publike për vitin pasues lista e pronave duhet të votohet jo më vonë se deri më datën 31 Dhjetorë të vitit aktualë për shembullë nga viti 2026-të deri më datën 31 Dhjetorë ne duhet me votuarë listën e pronave që mendojmë me i dhënë në shfrytëzim deri në vitin 2027-të.

Arsyejsa që është vonuar për me u votuar kjo listë deri në muajin Mars e kemi pranuarë shkresën e MAPL-së që Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ju ka lejuarë hapsirë të gjitha Komunave për me shtyrë këtë afat të votimit për shkakë të zgjedhjeve të Kuvendit të Kosovës.

Kjo listë ka mundësi të ndryshohetë në të shtohet apo të largohetë ndonjë pronë dhe parpë në muajin Dhjetorë ka me ardhur kjo listë me u votuarë për vitin 2027-të.

Ndërsa te pyteja e z.Imrannit, i cili pyeti se a kanë fleta poseduese pronat të cilat ipenë në shfrytëzim?Imranë tani përdoret qertifikata e pronësisë.Secila parcelë,secila njësi kadastrale e ka qertifikatën e pronësisë të vetën e ka edhe kopjen e planit madje edhe pronat publike.

Në pronat publike ka edhe ozurpime sepse nëse e shikoni numërin këtu pastaj hyni në veb faqen e Geoportalit do të shihni në mes të shtëpisë është një oborrë ose një shtallë apo ku ta di unë dhe ju mos e nënkuptoni këtë që Komuna ja ka dhënë në shfrytëzim por ju duhet të dini që kjo pronë është në ozurpim arbitrazhë sepse është në pronë publike.

Për derisa ka pronësi në emër të PSH të Kuvendit Komunal ajo është pronë shtetërore që ndoshta do të ishte dashur me qenë pronë publike nënkuptonë që pronësia është e Kuvendit Komunalë secila parcelë e ka numrin e njësisë e ka kopjenë e njesisë do me thënë është në aparatit rretholës.

Ne asnjë pronë nuk guxojmë me vendosur në listë dhe aq më pak me dhënë në shfrytëzim në qoftëse do të kishte mungesën e këtyre dy elementeve pra numrin e njësisë dhe kopjen e planit.

Ju keni me pasur raste por edhe unë e kam parë që në fshatin Carrallukë apo në fshatin Drenovc që në numrin e njësisë është ndërtuarë odë,shtallë apo shtëpi por ne nuk jemi fajtorë që ai e ka ozurpuarë pronën publike.Në të kaluarën pronës publike i kanë thënë pronë me renë.

Imran Xhyliqi(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Herën e kaluarë kur e kam ngritur këtë qështje e kam cekur Kryesus që në fshatin Marali e kam pasur një problemë,pastaj Kryesusi ka thënë mos u lëshoni në ato nivele se qfarë duke u bërë në Marali apo në Llapqevë.Të njejtën gjë e tha edhe sot që flisni për qështjet politike të juaja kurse në anën tjetër ju drejtua Vetonit që mos bëni gjithmonë politikë.Mos bini në kundërshtim me fjalët e juaja Kryesus.

Kryesus i Komiteti për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Jo nuk kam thënë për qështje politike dhe as për grupe politike të juaja,por qëndrimet e grupeve të juaja përballë pikave të rendit të ditës.

Imran Xhyliqi(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Unë e kam prejardhjen nga ai fshatë kurse ju e keni prejardhjen nga ai fshati tjetër dhe ne duhetë me i parë pak a shumë qëndrimet e bashkëfshatarëve tanë.

Kryesus i Komiteti për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:E saktë.Duhet me filluar secili me liruarë pronën që e ka ozurpuarë.

Imran Xhyliqi(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Kur të dëshirnoi si të dëshironi ia fillojmë kësaj pune.

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Jo,ka dokumente që prej vitit 2015-të kanë qenë antarë të Kuvendit Komunal kurse tani janë në nivel qëndrorë dhe janë ozurpatorë.

Imran Xhyliqi(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Kush do që e ka shkelë pronën publike eja ja nisim, kësaj pune deri në fundë nëse mendonë Kryesues që jam duke eladuarë një anë ja fillojmë kësaj pune deri në fundë.

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Jo nuk kam qfarë të mendojë në atë drejtim.

Imran Xhyliqi(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Ne nuk jemi ozurpuesë.

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:A ka ende dikush për debatë për pikën e dytë të rendit të ditës?Fjalën e ka kërkuarë z.Veton Zogaj.Urdhëro.

Veton Zogaj(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Unë për shembullë kisha propozuarë që në Kuvend që të paktën të ndahetë kjo listë që këto 45 (dyzetë e pesë) prona të cilat me numër rendorë janë nga 1 (një) deri në 45(dyzetë e pestë) janë edhe lista e veqantë e pronave të paluajtshme të cilat janë me prioritetë të paktën edhe këto prona me u pajisur me dokumentacionë shtesë me qertifikata të pronësisë,këto tjera po vërehenë që janë nëpër zona rurale dhe nuk është ndonjë ngarkesë për Drejtorinë,por të paktën disa prona janë nën zona urbane e disa në fshatra por për mos me përbuzurë disa në magjistrale,por është mirë me diturë me dokumentacionë.

Kur e keni ndërmendë ta caktoni seancën e Kuvendit Komunalë?

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Me datën 30 Marsë ditë e hënë.

Veton Zogaj(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Mendojë që dhjetë ditë është e mjaftueshëm që me na siguruarë materialin të paktën nga një kopje për secilin grup politikë,që mos me shpenzuarë shumë letra.

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Veton.

Muharrem Morina(zyrtar ligjorë në Kuvendin Komunal):Unë do ta bëjë një kalkulim meqenëse edhe z.Blerimi është matematicientë nëse janë 45(dyzetë e pesë) ose ende më shumë faqe edhe e fotokopjojmë për të gjithë Asambleistët llogaritet të dalin afërsishtë 1251 faqe.

Veton Zogaj(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Unë mendoj që do të ishte më lehtë vetëm për grupe.

Muharrem Morina(zyrtar ligjorë në Kuvendin Komunal):Po për grupe do të ishte më lehtë.

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Në Asamble Komunale ka rekomandime me shtuarë ose me larguarë prona,ne po ashtu mundemi me dërguarë edhe në email adresë.

Muharrem Morina(zyrtar ligjorë në Kuvendin Komunal):Nganjëherë në email adresë është problemë me dërguarë materialin punues se PDF-ja merrë shumë hapsirë.

Veton Zogaj(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Kemi edhe një mënyrë tjetër,mundemi me ardh në zyre edhe ju na ngarrkoni materialin punes në juesbi.

Kryesus i Komiteti për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Ne do të mundohemi por nëse nuk bënë përmes emailit e bëjnë kopje për grupet politike në Kuvend.

Pika e dytë e rendit të ditës?Shqyrtim dhe miratim i kërkesës nr.01/451 datë:03.03.2026 e parashtruar nga Kryetari i Komunës,për miratim të listës së pronave të paluajtshme të komunës së Malishevës,për dhënie në shfytëzim gjatë vitit 2026.

Atëherë kush është për që kjo pikë e rendit të ditës të rekomandohetë për Kuvend?

Rezultati i votimit.

Për 4 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 2 vota.

Miratohet me shumicën e votave dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 3

Pika e tretë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për ngritje të tarifës së shërbimit të mbeturinave nga "EKO-Regjioni"SHA.A.Prizren.

Kryesus i Komiteti për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:A keni interpretim z.Muharrem?

Muharrem Morina(zyrtar ligjorë në Kuvendin Komunal):Kërkesa ka ardhur në formë të nxituar në kuptimin që këto duhet me hyrë në procesë Plotësim Ndryshimi të Rregullorës për mirëmbajtje të ambientit,në kuadër të rregullorës me u para parë edhe ndryshimi i tarifës por nëse ju mendoni me dërguarë në Kuvend dhe me i dhënë epilogë kësaj qështje edhe si tarifë,por nëse jo ndoshta është më mirë me shkuarë me Plotësim Ndryshim të Rregullorës dhe në kuadër të saj me vendosur edhe tarifën si e mendoni ju edhe pse e ka ngritur EKO-Regjioni në shumën prej 7.5€ nuk do të thotë që ju ta miratoni në 7.5€ ajo mundet me u miratuar edhe në shumën 8.0€, 9.0€, ose 6.0€ ajo është një pikë orientuese.Në Prizrenë ajo është e orientuarë në shumën prej 7.5€,në Suharekë janë orientuarë në shumën prej 7.0€ ata vitin e kaluarë nuk mundur me kaluar gjithashtu edhe në Rahovecë.

Në kosto financiare në shërbim që ofronë EKO-Regjioni më së shumti dëmtohetë Malisheva dhe kjo është për shkakë të largësisë,llogariteni prej Berishës,prej Gllubovcit,prej Llapqevës kanë me marrë mbeturinat dhe kanë me i dërguarë në Llandovicë në Prizrenë ajo është kosto financiare,te derivatet pastaj ulja,mirëmbajtja e kështu me rradhë kjo është pra arsyeja.

E di që z.Vetoni sigurishtë që ka me thënë se do të dëmtohenë qytetarët prej kësaj shume por të keni parasyshë që një pjesë e kësaj tarife ka me u orienuarë në pagën e punëtorëve nuk ka ndonjë produktë tjetër pra vetëm kosotoja e shërbimit dhe paga e punëtorëve nuk ka diqka tjetër ekstra.

Kryesus i Komiteti për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Për cilën Rregullore bëhetë fjalë?

Muharrem Morina(zyrtar ligjorë në Kuvendin Komunal):Rregullorën për mirëmbajtjen e ambientit

Kryesus i Komiteti për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:A do ta themelojë Kuvendi Komunal?

Muharrem Morina(zyrtar ligjorë në Kuvendin Komunal):Rregullorën për mirëmbajtjen e ambientit e ka Komuna,vetëm me hyrë në plotësim ndryshim dhe në kuadër të saj me vendosur edhe tarifën.

Kryesus i Komiteti për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Atëherë unë e rekomandojë që të largohetë fillimishtë kjo pikë dhe të formohetë komisioni për hartimin e Rregullorës këtë me kërkuarë prej Kuvendit.

Veton Zogaj(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Ne do ti themi rekomandimet tona edhe kur të bëhetë ai komisionë,unë pajtohna që tani janë ngritur qmimet,por mos të harojmë që ne Komuna e Malishevës jam duke e thënë me plotë bindje sepse i kam pyetur së paku shtatë Komunat e tjera që janë të ngjajshme me neve për afërsishtë me numrin e njejtë të numrit të banorëve, kur jemi duke folur tani për tani ne e kemi tarifën më të lartë se Komuna e Fushë Kosovës,Lipjanit,Vushtrisë ata e kanë shumën prej vlerës 4.5€ kurse ne e kemi 5.5 € aktualishtë.

Unë e kam parasyshë që ne e kemi më larg në krahasim me Komuna e tjera mirëpo ne të paktën prej Kryeshefit z.Burimit ne nuk kemi marrë asnjë raportë prej tij për me ditur prej sa antarëve përbëhetë stafi i tij edhe realishtë qytetarët janë të pa kënaqurë nga niveli i mbledhjes së mbeturinave që e bëjnë,të paktën jam duke folur nga zona që vijmë ne,rrallë ndodhë që me qenë efikasë i dëmtojnë edhe kontinerat e banorëve dhe nuk ia kompenzojnë asnjëherë do me thënë ne jemi duke paguarë kosto për këtë.

Unë jam i nxitur edhe nga zotimet që i ka premtuar Kryetari i Komunës gjatë kandidimit për Kryetar të Komunës që kanë qenë para gjashtë muajve: Ai ka thënë që në mandatin e ardhshëm që fitojë do ta bëjë një ndërmarje publike Komunale që në kuadër të asaj ndërmarje publike Komunale ka me trajtuarë edhe qështjen e mbeturinave.Pse po nxitohetë pse nuk po e themelonë ndërmarjen dhe me u shkëputurë prej EKO-Regjionit e cila është ndërmarje Rregjionale dhe neve na fakturonë?

Le ta themelonë ndërmarjen.Komuna e Drenasit e ka themeluarë ndërmarjen.Jam duke u betuarë para juve vetëm le të fillojë kërkesa unë do ta shtyejë përpara nivelin qëndrorë dhe e themelojmë Ndërmarjen Komunale,pastaj ne e dime që Kuvendi Komunal është aksionare në atë ndërmarje dhe ne i mbajmë përgjegjës ata zyrtarë që punojnë aty.

Ne duke qenë si Komuna e fundit në cepë nganjëherë me Gjakovë e nganjëherë me Prizrenë gjithmonë bara më e rendë po na bie neve për secilën qështje,ky është një parim që duhet me u shtyrë përpara.

Muharrem Morina(zyrtar ligjorë në Kuvendin Komunal):Më lejoni të jepi një sqarim,z.Veton nuk e di a e dini që përfaqësues i Komunës në bordë jam unë.Raporti jem për Malishevë dorëzohetë në Komisionin e Aksionarëve,Kryesus i Komisionit ka qenë Valoni kurse antarë kanë qenë Hamiti dhe Valmiri unë dy apo tri takime i kam pasur me ata,raportin ja kam dorëzuarë.

Raporti i EKO-Regjionit nuk i dorëzohetë Komisionit të Aksionarëve të Malishevës por i dorëzohetë njësisë së Malishevës.Ju nuk keni nevojë me ditë për shembullë se qfarë po ndodhë në Suahrekë apo Rahovecë sepse ata i kanë komisionet e veta.Ne për Malishevë jo sot por nesër apo kur të doni në momentin që legjitimohet komisioni i Aksionarëve,unë e pregaditi raportin për Malishevë dhe ja dorëzojë komisionit të Aksionarëve.Kryetari apo Kryesusi i Aksionarëve mundet me njoftuar apo me prezantuarë në Kuvend Komunalë.

Tarifa për një familje është në shumën prej 5.5€ prej kësaj shume 1€ shkonë për KMDK transferohet te kompania për menagjimin e deponimit të mbeturinave një tonë që e dorëzonë kompania kushtonë në shumën prej 10€ tani llogariteni sa kg tona barten gjatë javës.

Qytetarët nuk janë duke e ditur dallimin sepse kompania ka të bëjë me grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave.Kompania i merrë mbeturinat e amviserisë familjare dhe nuk e ka për obligim që para shtëpisë apo lokalit me i grumbulluarë dhe me i pastruarë mbeturinat e tjera sepse ajo ka kosto shtesë sepse nuk kanë stafë për këtë shërbim,gjithashtu nëpër ledina,fshatra banorët të cilët i hudhin mbeturinat puntorët e kompanisë nuk e kanë për obligim me i grumbulluarë nuk është ky problemë i kompanisë.

Nëse Komuna i fakturonë dhe e rritë numrin e stafit të punëtorëve në EKO-Regjion atëherë kompania e merrë për sipër me i pastruarë edhe ato mbeturina,sepse në qytet i ka kurse nëpër fshatra nuk i ka.

Unë besoj edhe pse nuk jam duke dashur me folur për këtë kompani vetëm sepse jam përfaqësues në këtë kompani,por në nivel të Kosovës.kompania e EKO-Regjionit është në nivelin më të mirë të mundshëm duke e krahasur me Prishtinën që nuk e di nëse jeni duke i parë lajmet që janë tmerrë,gjithashtu në krahasim edhe me disa Komuna të tjera janë shumë keq.

Ne nuk jemi keq,ne mundemi me qenë edhe më mirë.Në Lladrocë në shumën prej 5.5€ me ardhë katër herë me të marë mbeturina llogariteni.Nëse ju mendoni që është shumë e madhe mos e votoni mirëpo kjo e bie në bankrotë edhe njësinë.

Veton Zogaj(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Shuma prej 5.5€ për një familje nuk është shumë e madhe mirëpo nuk është edhe shumë e vogël.Pse po donë me u ngritë kjo shumë?Përderisa ne nuk e kemi një raportë prej njësisë tonë në Malishevë me na treguarë sa është numri i punëtorëve.Ju z.Muharremi mundeni me ditë më mirë se sa punëtorë i ka sepse ju keni qenë pjesë e brendshme aty.Unë e di që kjo kompani paganë zyrtarë të cilët nuk mirenë fare me këtë punë.Unë nuk e kam këtë listë por është mirë që Kryeshefi apo Kryesusi nuk e di si e kanë me emërtim ose Udhëheqësi i njësisë së EKO-Regjionit në Malishevë po e quajë më mirë me na sjellë neve si Asambleistë listën e punëtorëve se ku janë të angazhuarë.Unë nuk jam duke i

përmendur me emra sepse pastaj kalonë në qështje personale,por mundem brenda pesë sekondave me i përmendur emrat e atyre që marrin pagë prej kësaj kompanie si puntorë mirëmbajtës të kësaj kompanie dhe punojnë një punë krejtë diçka tjetër.Prandaj unë jam kundër kësaj tarife për me u ngritur për arsyeje se fillimishtë unë dëshirojë me ditë se kush merrë pagë prej kësaj kompanie dhe a e kryenë këtë shërbim.Nëse i ka njëzetë apo tri dhjetë apo pesë dhjetë persona dhe të gjithë janë stafë i kësaj kompanie që punojnë këtë punë në rregullë.Dëshirojnë me ngritur pagën në e votojmë si Antarë të Kuvendit,por nëse ai puntori punonë në palestër dhe këtu figuronë në listë të pagave sikur punëtorë i kompanisë këto e ulin koston e shpenzimeve.

Janë edhe disa probleme të tjera ju e dini z.Muharrem që është përfolur që Udhëheqëzi i njësisë ka qenë i arrestuarë,janë shumë faktorë që ne duhet me pasur një raportë nuk dëshirojë me cekur me emra sepse nuk dëshirojë të hyjë në konfliktë me askënd.Unë poropozojë që kjo pikë e rendit të ditës të largohet dhe Kuvendi me dhënë arsyetimin nëse kalonë apo nuk kalonë.

Kryesus i Komiteti për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Unë e kam pasur një propozim para se me marrë fjalën z.Vetoni.Unë kërkova rekomandim dhe interpretim në aspektin ligjorë dhe unë vlerësojë që më së miri është me kërkuarë me themeluarë komisionin por nuk e di a e themelonë Kryetari apo është pjesë e Kuvendit.Janë disa komsione që formohenë vetëm prej Kryetarit siq janë për shembull komisioni për gjoba dhe tarifa ndoshta ka mundësi edhe në këtë rast të themelohenë vetëm nga Kryetari.A duhet me sjellur në Kuvend?

Muharrem Morina(zyrtar ligjorë në Kuvendin Komunal):Ne Rregullorën e kemi mundeni me bërë plotësim ndryshimin e Rregullorës për shërbime publike,në komitet e sjellni draftin e shqyrtoni.

Kryesus i Komiteti për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Unë e vlerësojë që mënyra më e mirë është që të plotësohet dhe ndryshohet Rregullorja dhe pastaj të dërgohetë në Kuvend.Rekomandohet përmes Rregullorës trajtimi i tarifës ose i kërkesës së EKO-Regjionit.

Kush jeni për që të ndryshohet dhe të formulohet përmes Rregullorës kërkesa për ngritje të tarifës së shërbimit të mbeturinave nga "EKO-Regjioni"SHA.A.Prizren?

Rezultati i votimit.

Për 4 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 2 vota.

Miratohet me shumicën e votave dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 4

Pika e katër e rendit të ditës:Të ndryshme.

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Te pika të ndryshme e kemi Drejtorin për Ekonomi dhe Financa z.Blerim Thaçi cili do të na prezantojë raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor 2025-të.Fjala është për juve Drejtorë,urdhëro.

Blerim Thaçi(Drejtor për Ekonomi dhe Financa):Faleminderit Kryesues.Në muajin Mars është periudha ligjore që duhet me prezantuar para Kuvendit raportin e pasqyrave dhe të hyrave për vitin e kaluar,nuk e di pse nuk është raportuar raporti i dyti dhe i tretë shkaku i zgjedhjeve.

Para juve do të prezantojë raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor të vitit 2025-të në pika të shkurta.

Ju e dini që për vitin 2025-të legjislatura e kaluarë ka votuarë buxhetin në shumën prej 21,576,545.00 € për të gjitha programet dhe nën programet,ky buxhet është aprovuarë nga Asambleja,kurse nga Qeveria është para pare në ngritje te kategoria e pagave që periudha e gjashtë mujorit të pare ka qenë 327,571.78 € dhe shuma e pjesës së dytë 830,017.17 € në kategorinë e pagave dhe duke e shtuar të barturat e vitit të kaluarë nga viti i kaluar që ka qenë në shumën prej 338,743.92 € si total i buxhetit të alokuar për vitin 2025-të është 23,072,877.87 €.

Ky buxhet është i alokuar në vitin 2025-të dhe shkalla e realizimit të alokimit është 90% ndërsa shkalla e realizimit 99% do me thënë të shpenzuara për vitin 2025-të janë 22,862,384.51 € nëse e vreni ku është cekur te përqindja e përgjithshme teknikisht është renditur gabimisht te shkalla e realizimit të shpenzimeve me shkallën e alokimit do me thënë shuma prej 23,072,877.87€ është dashur me qenë pjestuesë i shkallës së realizimit të shpenzimeve që do me thënë prapë realizimi i shpenzimeve është 99% jo 101% nëse jeni duke e vërejtur në faqen e parë,këtu duhet me rregulluarë një gabim teknik që është bërë.

Ndërsa për vitin 2025-të të hyrat vetanake kanë qenë të planifikuara në shumën prej 1,505,526.00€ edhe këtë vitë fatbardhsishtë kemi pasur tejkalim i të hyrave,ajo qfarë është e prezantuarë para juve duhet të keni parasyshtë të hyrat vetanake dhe të hyrat nga gjobat në trafikë dhe gjobat nga gjykata si totalë është në vlerën e prezantuarë para juve 1,975,019.33€ kur i bëjmë bashkë me këtë pjesën e të hyrave shtesë që e përmenda tek tre mujorshi i parë dhe i dytë nga gjobat e gjykatës dhe trafikut totali i saj është 2,243,547.06 €.

Para juve është e prezantuarë 740,000.00 € tejkalim të hyrave mirëpo si total i të hyrave të pa shpenzuara dhe qe do të barten për vitin 2026-të është 1,041,000.00 € shtrohet pyetja pse e kemi këtë shumë arsyeja është sepse te ju në këtë raportë nuk janë paraqitur raporti i mujait të tretë dhe të katër nuk janë të përfshierë të hyrat nga gjobat e trafikut dhe gjobat nga gjykata arsyeja është sepse nuk kanë pasur mundësi me bërë alokimin e këtyre mjeteve dhe kanë mbetur me u shpenzuar për vitin 2026-të kjo është në pika të shkurtëra unë pak a shumë do të ju përgjigjem edhe pyetjeve të juve por për më gjerësishtë mundemi edhe në Asamble Komunale.Faleminderit.

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Faleminderit Drejtorë për prezantimin.E hapi debatin.Fjalën e ka kërkuar z.Veton Zogaj.

Veton Zogaj(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Kryesues unë nuk do të flas shumë sepse realishtë fjalën e marrë edhe në Kuvend,nëse e marrim tani materialin këtu dhe fillojmë me trajtuarë shumë shifra është e pamundur,Drejtori e dinë që ne kemi pasur edhe në madatin e kaluarë një relacion të mirë me të.Drejtor ju keni qenë korrektë dhe keni marrë pjesë vazhdimishë në takime tona jeni përgjigjur gjithmonë pyetjeve tona,ne do të vazhdojmë me debatin për më gjerësishtë në Kuvend.

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Veton.A ka dikush tjetër me marrë fjalën?Atëherë e hedhi në votim kush është për që raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor për vitin 2025 të rekomandohet në Kuvend?

Rezultati i votimit.

Për 5 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 1 votë.

Miratohet kjo pikë e rendit të ditës dhe i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Kemi pranuarë dy kërkesa përmes zyrës ligjore të parashtruara nga Kryetari i Komunës.

Kërkesë për shqyrtim dhe miratim të ndarjes së sipërfaqës prej 40 hektarë nga sipërfaqja e tërsishme prej 1666 mijë e 118 metra katrorë për propozimin e lokacionit të deponisë për mbeturina inerte të përcaktuara sipas vendimit të Kuvendit nr 02/219 të datës 05.05.2022 si dhe 4 hektarë për qëllim të zhvillimit të aktiviteteve afariste nga njësia kadastrale P72316001/02053/0 në vendim e quajtur Gajrakë rruga me Kulturë Tokë Pjellore mali i klasës së gjashtë në pronësi të Komunës së Malishevës.

Muharrem Morina(zyrtar ligjorë në Kuvendin Komunal):Kuvendi në mandatin e kaluar ka marrë vendim me i dhënë në shfrytëzim afatë shkurtër deri në 15 vite procedurës së Ankandit këtë sipërfaqe.Pasi është dërguar vendimi në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për konfirmim të ligjshmërisë.Ministria ka thënë që para se me i shpallur me i dhënë në procedurë të Ankandit duhet me i ndarë kadastratë shkresat e lëndës kur të ju dërgojmë për Kuvend i gjeniaty.Kuvendi e ka marrë vendimin dhe Ministria ka thënë që duhet me shfuqizuar këtë vendim dhe duhet me i ndarë parcelatë.Prej parcelës 16 hektarë me i ndarë në 3 parcella 2 me i dhënë në shfrytëzim dhe pjesa tjetër të mbetet ashtu.Kryetari ka filluar procedurën për me i ndarë.

Ne në mandatin e kaluar e kemi plotësuar kushtin e Ministrisë që duhet me shfuqizuar atë vendim dhe tani duhet me i ndarë parcelatë dhe prej parcelës 16 hektarë me i ndarë 8 hektarë me përkufizuar atë që është përcaktuar me vendim të Asamblesë vendë deponia dhe një pjesë tjetër për me dhënë në shfrytëzim për një periudhë afat gjatë përmes procedurës së Ankandit deri në 15 vite do me thënë vendimi është marrë dhe është kthyer mbrapa prej Ministrisë dhe ka thënë që duhet me i ndarë prej një parcellë me i bërë tri parcella,do me thënë ato dy parcella që dëshironi me i dhënë në shfrytëzim me i ndarë dhe me i dhënë në shfrytëzim afat shkurtër deri në 15 vite.

Lëndën e keni të proceduarë kompletë në Kuvend me vendimin e parë dhe shkresën e Ministrisë edhe vendimin e dytë që e ka shfuqizuar Kuvendi për shkakë të procedurave që janë kërkuarë.Kryetari ka kërkuarë që me i bërë në harmoni me shkresat e Ministrisë.Këtu është e cekur edhe me lloji e shkrimit në faqën e parë që ju kemi përmbajtur sygjërimit ose konkludimit për me i ndarë parcelatë pastaj me i dhënë në shfrytëzim afat shkurtër.Pra kjo është ajo plotësim ndryshimi i atij vendimi.

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:A ke ende debatë dikush për këtë pikë të rendit të ditës?Nëse nuk ka me marrë dikush fjalën e hedhi në votim.Kush është për që të rekomandohenë kërkesat e Kryetarit për trajtim në Kuvend?

Rezultati i votimit.

Për 5 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 1 votë.

Miratohet kjo pikë e rendit të ditës me shumicën e votave dhe i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Kalojmë me trajtimin e kërkesave nga zyra e Kryetarit.

Muharrem Morina(zyrtar ligjorë në Kuvendin Komunal):Kryesues këtu e kemi edhe një tjetër rast madje MAPL-ja nuk është fajtorë vendimin tonë e ka drejtuar në Ministrinë e Drejtësisë për me na paditur neve si Kuvend.Në mandatin e kaluarë prapë është marrë një vendim në bazë të kërkesës së Kryetarit dhe palës që në fshatin Llozicë Komuna ka shfaqur interesim me ja marrë palës 1 ari e 91 metra është vendimi e kemi shpallur zonë me interesë të veçantë e kemi marrur vendimi dhe e kemi dërguarë në Ministri.

Ministria ka kërkuarë sqarime shtesë pronën që kemi tentuarë me ja marrë palës për me zgjeru rrugën tonë me drejtuarë rrugën,prona ka qenë në hipotekë në bankë,ne i kemi thënë palës që duhet me sjellur një vërtetim të bankës që na lejonë me hyrë në këto procedura.Banka ja ka lejuar mirëpo Ministria ka thënë që largojeni nga hipoteka,realishtë me ligj kërkohetë që prona që merret ose këmbehetë nuk duhet me pasu barrë financiare e asnjë subjekti.Në rastin konkretë kjo ka qenë barrë në hipotekë e futur prej kompanisë.Në vitin 2025-të pala e ka larguarë nga hipoteka dhe ne tani e kemi rastin me kryerë këtë procedurë,por neve na është përvjedhur një gabim tenik nuk e di pse.Ne e kemi nxjerrur vendimin për me shfuqizuarë dhe ne nuk e kemi proceduarë më tutje në Ministri ose nuk i ka shkuarë materiali dhe për këtë arsyeje materialin e ka dërguarë në Ministrinë e Drejtësisë për me na paditur neve në Gjykatë sepse nuk e kemi zbatuarë urdhërin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.Ne me këtë veprim i kryejmë këto procedura e përmbushim kriterin e Ministrisë e që MAPL-ja e tërheqë lëndën prej Gjykatës dhe e dyta ne e lirojmë palën do me thënë ne e marrim 1 ari e 91 metra dhe e shpronsojmë dhe e qesim në emër të Kuvendit Komunal dhe pjesën tjetër pasi që të vlerësohet prej Ministrisë së Financave e këmbejmë me palën private.Vlerësimi bëhet në Ministri të Financave këmbimi bëhet në të njejtën zonë në Llozicë nuk ka diqka tjetër aty.Kjo është procedurë që ne duhet me plotësuarë.

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:E hedhi në votim kush është për që kjo pikë të rekomandohet në Kuvend?

Rezultati i votimit.

Për 6 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 0 vota.

Miratohet në mënyrë unanime dhe i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Kalojmë te kërkesat e trajtimit të qytetarëve.

Imran Xhyliqi(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Unë e kam një kërkesë të qytetarëve nga fshati Guriq atje kanë pëlsiturë ujrat e zeza edhe në fund të fshatit ku është rruga kryesore janë disa livadhe andej për rreth dhe është tokë bujqësore dhe kanë filluarë ujërat e zeza me dalur mbi to dhe është duke u djegur toka e fshatit,ka kërkesa edhe prej pronarëve të tokës është në dijeni,Kryetari,Drejtori i Urbanizmit mirëpo nuk kanë marrë masa anjëherë.Duke e pasur parasyshë që aty ka filluar edhe kundërmimi i ajrit nga ujërat e zeza i kanë parashtruarë kërkesë Drejtorit të Urbanizmit dhe Kryetarit por nuk janë marrë me këtë punë.Unë e kam konsideruarë të arsyshme që me parashtruarë si kërkesë edhe në KPF nëse mundemi me bërë diçka.Unë nuk e di saktë edhe si shkonë procedura,por duhet me marrë këtë qështje dhe me trajtuarë.A mundemi me trajtuarë në Kuvend?

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Qka është duke munguarë te kjo lëndë apo materie,unë kam mundësi nga kërkesa jote që e bëre me shkuarë te Drejtori i Urbanizmit dhe te Drejtori i Shërbimeve Publike me kërkuarë që me trajtuarë kërkesën e qytetarëve sepse kanë probleme me rrjetin e kanalizimit.Unë ju sygjerojë që këtë qështje me ngritur prapë në Asamble Komunale si shqetësim i drejtë për drejtë sepse nuk kemi ne materie që me rekomanduarë për Kuvend.

Imran Xhyliqi(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Në rregullë,unë e kam ngritur herën e kaluarë këtë shqetësim në Kuvend ata informatën në fjalë e kanë marë lidhur me rastin që e ceka,por nuk janë marrë me rastin.

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Gjdo presion është i mirë që qeverisja ekzekutive me qenë më e përgjegjëshme dhe me i kryerë obligimet ndaj qytetarëve.Unë mundem me marrë kërkesën tënde pasi që jemi duke e trajtuarë në komitet.Unë mundë të kërkojë një interpretim sepse në komitet nga një antarë i KPF-së është paraqitur një kërkesë për grumbullimin e ujërave të zeza në fshatin Guriq dhe ky rast të mirret seriozishtë përndryshe mundet të ketë reagime dhe protesta të tilla,qytetarët kanë të drejtë me u trajtuarë kërkesat e tyre në qfarë do metode që ata e vlerësojnë.

Imran Xhyliqi(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Ky rast është që gjashtë muajë dhe askush nuk është marrë.

Veton Zogaj(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Fillimishtë unë i kisha propozuarë z.Imranit ashtu njejtë si veprojë unë e shkruani një shkresë zyrtare Kryetarit në email adresë pastaj i bëni një sisi edhe Drejtorit të Shërbimeve Publike dhe i bashkangjitni materialin me fotografi nga vendi i ngjarjes.

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Kam pranuarë disa kërkesa nga qytetarët që disa janë parashtruarë nga viti 2025-të,disa nga viti 2026-të por jam munduarë me i zgjedhurë disa cilat janë më me prioritetë.

Dy kërkesa janë për kompensim të pronës,Sabit Mazreku dhe Arsim Hazrolli do me thënë të dy kërkesat unë i rekomandojë për Kuvend.

Veton Zogaj(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Në mandatin e kaluarë z.Argjend Thaçi kur ka qenë Kryesus,ne si Komitet kemi kërkuarë që këto kërkesa kur të na vijnë për me i shqyrtuarë në Kuvend prej Drejtorisë së Urbanizmit dhe Kadastrit me qenë të kompletuara me dokumentacionin përkatës me qertifikatën e pronës dhe të tjerat që duhet me u bashkangjitur.Nëse nuk e kompletone Drejtoria ne nuk e trajtojmë pastaj në Kuvend,ka qenë parim i grupeve politike që e kemi vendosur dhe nuk e kemi thyer asnjëherë kriterin.Nëse kërkesa nuk vie e kompletuarë nga Drejtori përkatëse ne e largojmë nga rendi i ditës atë kërkesë.

Kryesus i Komiteti për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Materialin faktikë e kanë,pastaj ana ligjore interpretimi mbesin në seancë me u trajtuarë për dy rastet.Kush është për që kërkesa e Sabit Mazrekut të shqyrtohet në Kuvend?

Rezultati i votimit.

Për 6 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 0 vota.

Miratohet unanimithtë propozimi dhe i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Kryesus i Komiteti për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Kush është për që kërkesa e Arsim Hazrollit të cilën e ka autorizuarë përmes avokatit të tij Bekim Kryeziut që të trajtohet në Kuvend?

Rezultati i votimit.

Për 6 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 0 vota.

Miratohet unanimithtë propozimi dhe i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Kryesus i Komiteti për Politikë dhe Financa z.Fatmir Ademaj:Unë i kam marrë pesë kërkesa që janë për sëmundje momentale dhe një kërkesë për djegijen e shtëpisë.

Unë rekomandojë që Sadik Mazrekut për djegijen e shtëpisë të ndahenë shuma prej 500 €.

Kurse për trajtim shëndetësorë të ndahet shuma prej 350 € për:Rexhep Zogaj,Ganimete Bytyqi,Valon Bytyqi,Besnik Halili dhe Hajrije Gashi edhe ju nëse na rekomandoni ndonjëherë për ndonjë rast,komiteti do ta trajtojë dhe ne do të mundohemi me i trajtuarë të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës në mënyrë të barabartë

Veton Zogaj(anëtarë i Komitetit të KPF-së):Ky trajtim i qështjes është shumë i ndjeshëm,ne zakonishtë e kemi shmangurë maksimumë debatin për këtë punë,por unë e di që na kanë mbeturë një numër i madh i kërkesave pa u trajtuarë nga viti 2025-të,kurse ju tani i keni sjellur disa

kërkesa të vitit 2026-të. Qfarë ka me ndodhur me ato kërkesat që janë parashtruarë në vitin 2025-të? Mirë është me folur me z. Argjendin apo stafin me marrë me diskutuarë për ato dhe me marrë një vendim, përndryshe mos me ju hyrë në hakë atyre që kanë bërë kërkesë.

Zakonishtë është mirë Kryesus me na lexuarë jo vetëm emrat dhe mbiemrat por edhe diagnozën e mjekut. Dorën në zemër nuk dëshirojë me besuarë që dikush mundet me bërë kërkesë për shembullë që është lënduarë duke luajturë futbollë dhe e ka thyerë këmbën dhe ta bënë një kërkesë për kompenzim për besë ka hije.

Duhet me ditur natyrën e sëmundjes sepse aty e ka një diagnozë, një raport të mjekut e ka.

Kryesus i Komiteti për Politikë dhe Financa z. Fatmir Ademaj: Një rast është me operacionë, dy me kancerë në bazë të dokumentacionit, besoj që herën e ardhshme me ju dhënë nga një kopje antarëve të komunitetit kërkesat e qytetarëve që janë parashtruarë për me qenë në njohuri të gjithë, sepse edhe me dashur me lexuar nuk di me lexuar diagnozën e mjekut në këtë mënyrë munden vetëm me bërë gabime.

Muharrem Morina (zyrtar ligjorë në Kuvendin Komunal): Nëse ka fletë lëshim prej spitalit në hyrje ju shkruanë CA dhe pastaj diagnoza është me kancerë.

Veton Zogaj (anëtarë i Komitetit të KPF-së): Këtë herë le të shkonë në këtë formë.

Muharrem Morina (zyrtar ligjorë në Kuvendin Komunal): Në mandatin e kaluarë ka qenë një parim rastet me kancerë janë trajtuarë në Kuvend për shkakë që i kanë kompenzuarë në shumën më të madhe.

Veton Zogaj (anëtarë i Komitetit të KPF-së): Në mandatin e kaluarë i kemi rekomanduarë për Kuvend zakonishtë dy ose tri rast më të rënda kurse ato më të lehta në Komitet.

Kryesus i Komiteti për Politikë dhe Financa z. Fatmir Ademaj: A do ti trajtojmë këtë herë në këtë formë dhe nëse mendoni se është shuma e vogël prej 350 € e bëjmë 400 € për trajtim shëndetësorë kurse për rastin e djegijes së shtëpisë ta kompenzojmë në shumën prej 500 €? Emrat dhe mbiemrat i lexova më herët atëherë shkojmë vetëm me procesin e votimit. Kush është për?

Rezultati i votimit.

Për 6 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 0 vota.

Miratohet unanimitë kjo pikë e rendit të ditës.

Ju faleminderit shumë të gjithëve për pjesëmarrjen shihemi në takimin e ardhshëm të Kuvendit.

Takimi përfundojë rreth orës 14:30.

Procesëmbajtjsja

Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa

Fatlume Delija



Fatmir Ademaj

